

VENDIM
Nr. 12, datë 9.3.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare e Gjykatës Kushtetuese
Elsa Toska	anëtare e “ “
Marsida Xhaferllari	anëtare e “ “
Fiona Papajorgji	anëtare e “ “
Përparim Kalo	anëtar i “ “
Sonila Bejtja	anëtare e “ “

me sekretare Belma Lleshi, në datën 9.3.2021, mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 47 (A) 2017 i Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Astrit Meli

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Nikolin Kodhima, Bukurije Agaj, Gramoz Haxhiraj, Meleqe Binaj, Bajram Meminaj, shoqëria “Cika” sh.p.k., shoqëria “Sevast” sh.p.k., Agjencia e Trajtimin të Pronave, Këshilli i Rregullimit të Territorit bashkia Vlorë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Vlorë

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë i vendimeve nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 11, 18, pika 1, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 31, 71, 71/a, 72 e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Vitore Tusha, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuarit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, parashtrimet me shkrim të subjektit të interesuar, shoqërisë “Cika” sh.p.k., e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave (KKKP) Vlorë është vendosur njohja e pronësisë për një sipërfaqe truall prej 21.392 m², të ndodhur në lagjen “24 Maji” Vlorë, ish-pronarëve Kodhima, shtetasve XH.K., E.K., S.K. dhe XH.K., duke iu kthyer në natyrë 5.600 m² (prona objekt konflikti) dhe kompensimi për sipërfaqen prej 1.500 m². Si bazë për njohjen e kësaj prone rezulton të ketë shërbyer vendimi nr. 1449, datë 6.6.1995, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, i cili është bazuar në vërtetimin e pronësisë nr. 2980/1, datë 20.10.1936.

2. Me vendimin nr. 352, datë 14.2.1997, KKKP-ja Vlorë ka njohur si ish-pronar shtetasin Jonuz Binaj, për një sipërfaqe toke bujqësore dhe ka kompensuar fizikisht trashëgimtarin e tij Meleqe Binaj (Haxhiraj) me një sipërfaqe prej 4.800 m² tokë truall në lagjen “Çole” të qytetit të Vlorës, pikërisht

në vendin që po ky komision ka disponuar me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996. Me deklaratën noteriale nr. 633 Rep., nr. 266 Kol., datë 1.3.2006, Meleqe Binaj ka hequr dorë nga regjistrimi i kësaj prone në favor të familjes Kodhima. Formalisht vendimi nr. 352, datë 14.2.1997, i KKKP-së Vlorë ka mbetur në fuqi.

3. Në datën 31.7.2006 është lidhur kontrata e shitjes nr. 2556 Rep., nr. 889 Kol. midis shitësve XH.K., E.K., S.K. dhe XH.K. dhe blerësve Gramoz Haxhiraj (djali i Meleqe Binaj) e Bukurie Agaj, me objekt shitjen e një sipërfaqeje toke prej 2.949 m². Në datën 31.7.2006 është lidhur kontrata e shitjes nr. 2559 Rep., nr. 891 Kol. midis po së njëjtës palë shitëse dhe blerëses Bukurie Agaj, me objekt shitjen e një sipërfaqeje toke prej 2.371 m². Të dyja këto pasuri bëjnë pjesë në pasurinë që shtetasve Kodhima u ishte kthyer me vendimin nr. 106, datë 19.6.1996, të KKKP-së Vlorë.

4. Për këtë truall është marrë edhe leja e sheshit të ndërtimit e datës 24.11.2008 dhe leja e ndërtimit e datës 23.2.2009, për ndërtimin e objekteve 8–10 kate.

5. Po ashtu, rezulton se shtetasi Xhelal Meli, duke pretenduar se është pronar i kësaj sipërfaqeje toke, i është drejtuar gjykatës me padi me objekt detyrimin e të paditurve ta njohin pronar, anulimin e vendimeve të KKKP-së nr. 106, datë 19.6.1996 dhe nr. 352, datë 14.2.1997, si edhe pavlefshmërinë e të gjitha transaksioneve që janë bërë me këtë pronë. Ai ka paraqitur si provë përpara gjykatës një vërtetim arkivor, që përcakton madhësinë e sipërfaqes prej 7 vreten, në vendin e quajtur “Çole”, me kufij të përcaktuar të kohës. Sipas këtij vërtetimi arkivor, mbi këtë sipërfaqe toke ndodhej edhe një ndërtesë me konstruksion çimento e gurë e me çati me tjegulla dhe kjo pronë i është shpronësuar ish-pronarit Xhelal Meli në vitin 1948. Ky shtetas ka pretenduar se mbi themelet e kësaj ndërtese të vjetër pas viteve ‘90 ka ndërtuar një ndërtesë tjetër, që e përdor si punishte dhe që është në proces legalizimi. Sipas tij, nga verifikimet e kryera në arkivin pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) Vlorë, nuk rezulton të ketë nr. 2980/1 në regjistrin hipotekor të vitit 1936. Po ashtu, ai ka pretenduar në gjykatë, se ky truall në mënyrë të kundërligjshme, me vendime të KKKP-së, i është kthyer personave joekzistentë dhe përfundimisht u ka kaluar të paditurve.

6. Gjatë gjykimit është paraqitur shtetasi Bajram Meminaj me kërkesë për ndërhyrje kryesore, duke pretenduar se as paditësi dhe as të paditurit nuk janë pronarë të kësaj prone, por pronar është trashëgimlënësi i tij, shtetasi M.M.

7. Me vendimin nr. 580, datë 16.3.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka vendosur: “1. *Rrëzimin e padisë së paditësit Xhelal Meli si të pabazuar në prova.* 2. *Pranimin e padisë së ndërhyrësit kryesor Barjam Meminaj. Detyrimin e Xhelal Melit të njohë trashëgimtarët e Muhamet Meminaj pronarë të një sipërfaqe trualli prej katër vretenë ose 4.800 m² të ndodhur në lagjen “Çole” (sot lagja “24 Maji”), vendi Kume, me kufij të vjetër...* 3. *Detyrimin e të paditurve Bukurie Agaj, Gramoz Haxhiraj e Meleqe Binaj të njohin trashëgimtarët e Muhamet Meminaj pronarë të një sipërfaqe trualli prej katër vretenë ose 4800 m² tokë truall të ndodhur në lagjen “Çole”, vendi Kume, me kufij të vjetër...* 4. *Shfuqizimin tërësisht të vendimit nr. 106, datë 19.6.1996, të ish-KKKP-së të Bashkisë Vlorë, si i dhënë në kundërshtim me ligjin.* 5. *Anulimin e vendimit nr. 352, datë 14.2.1997, të KKKP-së pranë Këshillit të Rrethit Vlorë.* 6. *Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme: nr. 2556 rep. dhe nr. 889 kol., datë 31.7.2006; nr. 2559 rep. dhe nr. 891 kol., datë 31.7.2006, duke kthyer palët në gjendjen e mëparshme.* 7. *Detyrimin e ZVRPP-Vlorë të bëjë ç’regjistrimin e kësaj pasurie nr. 18/138, Zona Kadastrale 8604, në emër të të paditurve.* 8. *Anulimin e vendimit për miratimin e sheshit të ndërtimit mbi truallin objekt konflikti miratuar në datën 24.11.2008 dhe të lejeve të ndërtimit të dy objekteve, 8–10 kate me nr. 1/41, datë 23.2.2009.”.*

8. Me vendimin nr. 390, datë 23.4.2012, Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur: “Lënien në fuqi të vendimit nr. 580, datë 16.3.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.”. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë paditësi dhe të paditurit, si dhe ka paraqitur kundërrekurs ndërhyrësi kryesor.

9. Me vendimin nr. 00-2017-899 (72), datë 13.6.2017, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancë gjyqësore, ka vendosur: *“Lënien në fuqi të vendimit nr. 390, datë 23.4.2012, të Gjykatës së Apelit Vlorë.”*.

10. Me kërkesën e datës 13.10.2017, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor në proceset gjyqësore të zhvilluara në të tria shkallët e gjykimit.

11. Me vendimin e datës 12.1.2018, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh.

II

Pretendimet e palëve

12. Kërkuesi Astrit Meli, në cilësinë e trashëgimtarit ligjor të shtetasit Xhelal Meli, në kërkesën e tij ka parashtruar se janë cenuar:

12.1 E drejta e aksesit në gjykatë. Gjykatat, pa e hetuar çështjen, kanë rrëzuar kërkesëpadinë me arsyetimin se paditësit i mungon legjitimimi aktiv dhe se dokumenti arkivor i paraqitur prej tij nuk përbën provë për ta legjitimuar atë. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, pasi legjitimimi aktiv nuk ka lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, e cila lidhet me shqyrtimin e padisë në themelin e saj.

12.2 E drejta e mbrojtjes dhe parimi i kontradiktoritetit në gjykim. Në gjykimet në fakt nuk është ndërtuar drejt ndërgjyqësia dhe nuk janë thirrur në gjykim palë që kanë të drejta mbi pasurinë objekt konflikti. Po ashtu, gjykata ka marrë vendim për vazhdimin e gjykimit në mungesë dhe nuk ka vijuar me njoftimin e palëve në mungesë kur ka shtyrë seancat gjyqësore. Për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit gjykata e apelit duhej të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim, në kuptim të nenit 467 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

12.3 Parimi i barazisë së armëve, pasi gjykata ka ngatërruar rolin e saj me të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti, pa marrë dhe administruar në cilësinë e provave shkresore akte që vërtetojnë ose rrëzojnë këto konstatime. Kërkuesi është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që nëpërmjet gjykatës të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët dhe ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e shtetasit Xhelal Meli.

12.4 E drejta për t’u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata e apelit ka shkelur rregullat e përcaktuara në KPC, pasi ajo është tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit në datën 16.3.2012 por e ka vonuar shpalljen e tij pa shkaqe të përligjura.

12.5 Parimi i gjyimit nga një gjykatë e caktuar me ligj. Në zbatim të urdhërimit të nenit 181 të KPC-së, gjykimi në shkallë të parë nuk mund të vazhdonte aty ku ishte lënë në momentin e ndërrimit të dy gjyqtarëve, por duhej të niste nga fillimi.

12.6 Parimi i paanshmërisë në gjykim. Gjyqtari H.S., i cili ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, ka marrë pjesë më parë në dhënien e një vendimi për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë, ku është pranuar se prona e shtetasit Xhelal Meli gjendet në vendin e pretenduar prej tij në padi.

12.7 Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykatat i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, sipas të cilit është e vështirë të pasqyrohet vendndodhja e pasurisë së shtetasit Xhelal Meli, ndërkohë që ajo do të përcaktohej lehtësisht nëse gjykatat do të thërrisnin ekspertë me njohuri të posaçme. Për më tepër aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit dhe prona ka qenë e regjistruar edhe në regjistrin hipotekor të vitit 1942. Gjykatat janë shprehur se paditësit i mungon legjitimimi aktiv, me arsyetimin se dokumenti arkivor i paraqitur nuk përbën provë për

legjitimitimin, ndërkohë që dokumentin arkivor për pasurinë e Meminajve e konsideron si provë për legjitimitimin e ndërhyrësit kryesor. Gjykatat kanë anashkaluar dhe nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se shtetasi Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimeve objekt i padisë që lidhen me kthimin e pronës. Pavarësisht shkeljeve të konstatuara në këtë proces gjyqësor, Gjykata e Lartë i legjitimoi ato duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

13. Subjekti i interesuar, shoqëria “Cika” sh.p.k., në parashtrimet me shkrim drejtuar Gjykatës, ka prapësuar sa vijon:

13.1 Shoqëria “Cika” sh.p.k. për të zhvilluar aktivitetin në fushën e ndërtimit ka lidhur aktmarrëveshje me një nga pronarët e truallit, shtetasen Bukuriye Aga, e cila është bashkëpronare me shtetasin Gramoz Haxhiraj. Për këtë qëllim është marrë edhe leja përkatëse e vendimit dhe dokumentacioni i disponuar prej saj është i ligjshëm.

13.2 Marrja e masës së sigurimit nga gjykata, e pambështetur në ligj dhe në mungesë të kësaj pale ndërgjyqëse, ka bërë që të shkelen rëndë rregullat për formimin e ndërgjyqësisë.

13.3 Të tria shkallët e gjykimit nuk e kanë gjykuar në themel çështjen, sepse nuk janë bazuar në dokumentet arkivore që disponoheshin nga palët. Gjatë gjykimit vendndodhja e pronës, sipas dokumenteve arkivore, është zhvendosur, pra prona e shtetasit M.M. nuk është aty ku pretendohet. Harta topografike e paraqitur në gjykim nuk paraqet realitetin, sepse është ndryshuar në mënyrë të padrejtë. Për rrjedhojë, në rastin konkret është cenuar neni 42 i Kushtetutës.

14. Subjektet e tjera të interesuara nuk kanë paraqitur prapësime me shkrim në lidhje me pretendimet e ngritura në kërkesën në shqyrtim.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

15. Gjykata vë në dukje se prej datës 23 mars të vitit 2018 nuk ka pasur kuorumin e nevojshëm ligjor të kërkuar nga neni 32, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 për shqyrtimin e çështjeve në seancë plenare. Pas plotësimit të këtij kuorumi u bë e mundur marrja në shqyrtim e kësaj çështjeje.

16. Gjykata vëren, gjithashtu, se në datën 28.1.2021 gjyqtari Altin Binaj, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 36 të ligjit nr. 8577/2000, i ka paraqitur Kryetares së Gjykatës Kushtetuese kërkesë me shkrim për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak të lidhjeve fisnore me subjektet e interesuara, Meleqe Binaj (Haxhiraj) dhe Gramoz Haxhiraj.

17. Me vendimin e datës 9.2.2021, Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ka vendosur pranimin e kërkesës së gjyqtarit Altin Binaj për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes nr. 47 (A) 2017 i Regjistrat Themeltar, me kërkuar Astrit Meli, në kuptim të pikës 2 të nenit 37, të ligjit nr. 8577/2000, pasi votat e gjyqtarëve u ndanë në mënyrë të barabartë.

A. Për legjitimitimin e kërkuar

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71, të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

19. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur.

20. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenin 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatën Kushtetuese dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

21. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve ligjore*, Gjykata ka theksuar se, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion përfundimtar, që do të thotë se mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë marrë fund procedurat gjyqësore. Kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar, që do të thotë se individit duhet t’i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Shterimi nënkupton se kërkuesi duhet t’i shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 17, datë 16.5.2011, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky rregull nënkupton jo vetëm që individit t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngrenë në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimet nr. 8, datë 19.3.2018; nr. 31, datë 25.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të paanshmërisë në gjykim, pasi, sipas tij, gjyqtari H.S., që ka marrë pjesë në shqyrtimin e çështjes në shkallë të parë, ka qenë më parë pjesë e trupit gjykues që ka dhënë vendimin për vërtetimin e faktit juridik të pronësisë, ku është pranuar se kufitar i pronës është shtetasi Xhelal Meli, pra se prona e tij gjendet në vendin e pretenduar në padi.

23. Gjykata, bazuar në aktet bashkëlidhur kërkesës, vëren se ky pretendim i kërkuesit nuk është ngritur më parë në rekursin e paraqitur në Gjykatën e Lartë dhe as në parashtrimet e paraqitura në seancën gjyqësore para asaj gjykate. Në parashtrimet e tij drejtuar kësaj Gjykate kërkuesi ka pretenduar se e ka ngritur këtë pretendim në seancat gjyqësore në gjykatën e apelit dhe Gjykatën e Lartë, por nga aktet e dosjes gjyqësore, të administruar për qëllime të këtij gjykimi, konkretisht nga procesverbalet e seancave gjyqësore, nuk rezulton i provuar ky fakt. Gjykata vëren se kërkuesi jo vetëm që nuk ka paraqitur prova në mbështetje të pretendimit për cenimin e parimit të paanshmërisë nga pjesëmarrja në gjykim e gjyqtarit H.S., por nuk ka provuar se e ka shteruar këtë pretendim në shkallët e gjykimin të zakonshëm. Në këto kushte, për sa kohë që kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion, Gjykata nuk do të vijojë me vlerësimin e këtij pretendimi.

24. Kërkuesi legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor të parashikuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

25. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesi ka pretenduar cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit për shkak të mosformimit të drejtë të ndërgjyqësisë, si pasojë e mosthirrjes në gjykim të palëve që kanë të drejta mbi pasurinë objekt konfliktit. Sipas tij, gjykata duhej të thërriste në gjykim shtetasen D.G., në emër të së cilës figuron e regjistruar prona objekt konfliktit, si edhe trashëgimtarët e shtetasit M.SH. Gjykata vëren se, në kuptim të nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, individit, si subjekt i kushtëzuar, mund të bëjë kërkesë në Gjykatë vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, si dhe të provojë se në ç’mënyrë ai është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese.

26. Për sa më sipër, për sa kohë që kërkuesi parashtron pretendime që nuk lidhen me cenimin e drejtpërdrejtë të së drejtës së tij kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, por kanë synim mbrojtjen e të drejtave të personave të tretë, ai nuk legjitimohet, pasi nuk ka provuar të drejtën e cenuar dhe interesin e tij të ligjshëm vetjak për mbrojtjen e saj.

27. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se gjykata e apelit ka shkelur rregullat e përcaktuara në KPC, pasi ajo është tërhequr në dhomën e këshillimit për marrjen e vendimit në datën 16.3.2012 dhe ka vendosur shtyrjen për shkak të kompleksitetit të çështjes. Sipas tij, edhe pse çështja ka qenë në gjykim në atë gjykatë për gati 1 vit, asaj i është dashur ende kohë për të konkluduar me vendim, duke vonuar shpalljen e tij pa shkaqe të përligjura. Në lidhje me këtë pretendim Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk ka arritur ta ngrejë në nivel kushtetues, duke mos arritur të provojë pasojat e ardhura dhe cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor.

28. Po në kuptim të legjitimitetit *ratione materiae*, pretendimet e tjera të ngritura nga kërkuesi janë të tilla që *prima facie* bëjnë pjesë në juridiksionin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së aksesit në gjykim

29. Sipas kërkuesit gjykatat, pa zhvilluar hetim gjyqësor, kanë rrëzuar kërkesëpadinë me arsyetimin se i mungon legjitimiteti aktiv dhe se dokumenti arkivor i paraqitur prej tij nuk përbën provë për ta legjitimuar. Ky qëndrim i gjykatës është i gabuar, pasi legjitimiteti aktiv nuk ka lidhje me bazueshmërinë në prova të padisë, por kjo e fundit lidhet me shqyrtimin e padisë në themelin e saj.

30. Në nenin 42, pika 2, të Kushtetutës parashikohet se kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj. Kjo dispozitë sanksionon të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit u garanton subjekteve të cenuara të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal (*shih vendimet nr. 56, datë 25.7.2017; nr. 21, datë 20.3.2017; nr. 52, datë 14.11.2014, të Gjykatës Kushtetuese*). Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimin nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Gjykata vëren se në vendimin nr. 580, datë 16.3.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka arsyetuar: “Duke iu referuar akteve në dosje rezulton se paditësi ka paraqitur si provë për të provuar pronësinë e tij një dokument arkivor të dalë nga Arkivi i Shtetit... Në këtë dokument arkivor jepen specifikimet e pronës dhe konkretisht... Ky dokument nuk është i shoqëruar me skicë. Për të përcaktuar faktin se ku ndodhet prona e paditësit dhe nëse midis saj dhe pronës së të paditurve apo asaj të pretenduar nga ndërhyrësi kryesor ka apo jo mbivendosje, nga gjykata u procedua me vendosjen e një eksperti. Në përfundim nga eksperti u arrit në përfundimin se për kufitarët e kësaj prone nuk ka asnjë dokument grafik... Për këto arsye, pra për faktin se dokumenti nuk ka hartë (skicë) apo nuk ka të përcaktueshëm kufijtë e pronës, ekspertja nuk mund të përcaktojë se ku ndodhet kjo pronë, pra nuk mund të përcaktohet nëse ndodhet pikërisht aty ku të paditurit kanë pronën e tyre apo ndonjë vend tjetër. Nga paditësi nuk u sollën prova të tjera sikurse do të ishte dokumenti i pronësisë së kufitarit të tij apo ndonjë dokument tjetër për të bërë të mundur të përcaktohej se ku pikërisht është vendosur prona e tij. Pra, paditësi nuk arriti të provojë legjitimitetin aktiv në padinë e tij, pra nuk arriti të provojë cenimin e ndonjë interesi të tij të ligjshëm që të involvonte gjykatën në zgjidhjen e ndonjë konflikti me të paditurit. Për mungesë të legjitimitetit aktiv, gjykata pa i hyrë themelit të padisë së paditësit do ta rrëzojë atë si të pabazuar në prova.” Kurse në lidhje me legjitimitetin aktiv të ndërhyrësit kryesor, gjykata ka vlerësuar se edhe pse prej tij u soll si provë një dokument arkivor i dalë nga Arkivi i Shtetit, i pashoqëruar me skicë, u paraqitën si provë edhe dokumentet e kufitarëve, në bazë të të cilave eksperti arriti në përfundimin se prona e tij ndodhet në vendin ku të paditurve u është kthyer prona me vendim komisioni.

32. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se përdorimi i mjetit procedural të përshtatshëm ankimes, në formë e në përmbajtje, siç sanksionohet në legjislacionin procedural, nuk përbën një kërkesë formale, por një kërkesë që lidhet me thelbin e së drejtës së mbrojtjes dhe të pjesëmarrjes aktive në gjykim. Në përputhje me këtë, neni 31 i KPC-së e ka përkufizuar padinë si të drejtën për t'u dëgjuar të personit që ngre pretendimin, në mënyrë që gjykata ta shpallë atë të bazuar ose jo në fakte e në ligje, kurse neni 32, shkronja "a", parashikon se padia mund të ngrihet për të kërkuar rivendosjen e një të drejte ose interesi të ligjshëm që është shkelur (*shih vendimet nr. 38, datë 30.6.2014; nr. 5, datë 20.3.2006, të Gjykatës Kushtetuese*). Sipas nenit 12 të KPC-së, pala që pretendon një të drejtë ka detyrimin të provojë faktet mbi të cilat bazon pretendimin e saj. Në këtë kuptim, është pala që vë në lëvizje gjykatën që ka detyrimin të provojë pretendimet e saj dhe të paraqesë provat për këtë qëllim.

33. Në çështjen në shqyrtim rezulton se kërkuesi (paditësi në procesin gjyqësor), në mbështetje të pretendimit të ngritur në padi, për të vërtetuar pronësinë, ka paraqitur një dokument arkivor, i cili sipas gjykatës së zakonshme nuk ka qenë i mjaftueshëm për ekspertin e caktuar prej saj për të konkluduar në lidhje me vendin se ku ndodhet prona e përcaktuar në dokumentin arkivor. Mbi këtë vlerësim gjykata, duke iu referuar normave ligjore që lidhen me të provuarit e interesit të ligjshëm për të ngritur padinë, ka arritur në përfundimin se kërkuesi nuk ka legjitimitimin aktiv në ngritjen e padisë në shqyrtim.

34. Për sa më sipër, Gjykata konstaton se kërkuesi, lirisht, ka ushtruar të drejtën e ngritjes së padisë dhe përmes një procesi gjyqësor, që ka analizuar themelin e çështjes, me vendim përfundimtar ka marrë përgjigje për të gjitha pretendimet e tij, përfshirë edhe atë të legjitimitimit aktiv.

35. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuetit është i pabazuar.

C. Për pretendimin e cenimit të së drejtës së mbrojtjes dhe parimit të kontradiktoritetit në gjykim

36. Sipas kërkuetit, gjykata ka marrë vendim për vazhdimin e gjykimit në mungesë të palëve dhe nuk ka vijuar me njoftimin e tyre kur ka shtyrë seancat gjyqësore. Mosrespektimi i rregullave për njoftimin përbën shkak për shfuqizimin e vendimit nga gjykata e apelit, e cila duhej të vendoste kthimin e çështjes për rigjykim, në kuptim të nenit 467 të KPC-së.

37. Gjykata në jurisprudencën e saj ka përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës, në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjake në raport me palën kundërshtare (*shih vendimin nr. 37, datë 30.6.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

38. Me qëllim garantimin e të drejtave të palëve në proces, gjykatave të zakonshme u dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në gjykim, si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

39. Gjykata ka vlerësuar, gjithashtu, se kontrolli i kushtetutshmërisë së një vendimi gjyqësor vlerësohet në një kontekst të caktuar faktesh që lidhen me të drejtën për proces të rregullt ligjor. Rastet që i paraqiten Gjykatës mbi bazën e ankimit të individëve, duhet të shqyrtohen domosdoshmërisht në bazë të provueshmërisë së fakteve të dhëna. Marrja e vendimit për çështje

kushtetuese kushtëzohet nga përcaktimi i fakteve kushtetuese, mbi bazën e të cilave vlerësohet respektimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përderisa Gjykata Kushtetuese ka autoritetin për të vendosur përfundimisht për çështje të kushtetutshmërisë së procesit gjyqësor, ajo nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa analizuar faktet e natyrës kushtetuese (*shih vendimin nr. 39, datë 5.5.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Në lidhje me pretendimin për cenimin e parimit të kontradiktoritetit në gjykim për shkak të mosrespektimit të rregullave të njoftimit, kërkuesi nuk ka argumentuar se cilit proces i referohet konkretisht. Gjykata, bazuar në aktet e dosjes gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi, vëren se si në procesin gjyqësor të zhvilluar në gjykatën e shkallës së parë, ashtu edhe atë në apel, paditësi ka marrë dijeni rregullisht për të gjitha seancat gjyqësore dhe rezulton se ai ka qenë i pranishëm në to ose personalisht, ose i përfaqësuar nga përfaqësuesit e zgjedhur prej tij. Edhe ato seanca gjyqësore ku paditësi ose përfaqësuesi i tij nuk kanë qenë të pranishëm, rezulton të jenë shtyrë për shkaqe të caktuara dhe nuk rezulton të jetë zhvilluar hetim gjyqësor ose të jenë kryer veprime të tjera procedurale në lidhje me çështjen.

41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se edhe ky pretendim i kërkuesit është i pabazuar.

Ç. Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve

42. Kërkuesi ka pretenduar cenimin e parimit të barazisë së armëve, pasi gjykata ka ngatërruar rolin e saj me të ekspertit, duke disponuar me vendim vetëm atë çka ka konstatuar eksperti. Kërkuesi është vënë në situatë të disfavorshme në krahasim me palën tjetër, pasi gjykatat jo vetëm që nuk kanë pranuar kërkesat e tij për paraqitjen e provave, por i kanë mohuar të drejtën që, nëpërmjet gjykatës, të sigurojë provat e nevojshme shkresore ose me dëshmitarë për të vërtetuar pretendimet e tij. Gjykatat nuk kanë marrë parasysh pretendimet e paraqitura nga palët dhe ato duhej të thërrisnin një grup ekspertësh për të saktësuar pronësinë e shtetasit Xhelal Meli.

43. Parimi i barazisë së armëve nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij dhe se asnjë palë nuk duhet të gëzojë avantazh të konsiderueshëm ndaj palës tjetër, por duhet të përcaktohet një ekuilibër i drejtë mes tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykimin civil, atëherë argumentet e njërës palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

44. Gjykata vëren se sipas nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000, kur nuk formohet shumica prej 5 gjyqtarësh, kërkesa konsiderohet e rrëzuar. Bazuar në këtë dispozitë, në lidhje me pretendimin e kërkuesit për mospranimin nga gjykata e zakonshme të kërkesës për thirrjen në gjykim të një grupi ekspertësh, në kuptim të parimit të barazisë së armëve në gjykim, në kushtet kur nuk u arrit shumica e votave¹ në lidhje me bazueshmërinë ose jo në themel të këtij pretendimi, ai konsiderohet i rrëzuar.

D. Për pretendimin e cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj

45. Sipas kërkuesit, në zbatim të urdhërimit të nenit 181 të KPC-së, gjykimi në shkallë të parë nuk mund të vazhdonte aty ku ishte lënë në momentin e ndërrimit të dy gjyqtarëve, por duhej të niste nga fillimi.

46. Gjykata ka vlerësuar se një nga elementet e procesit të rregullt ligjor, sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së, është edhe shqyrtimi i çështjes nga një “*gjykatë e caktuar me ligj*”. Ky element karakterizohet, në sensin material, nga funksioni i saj gjyqësor, që ka të bëjë me zgjidhjen e çështjeve nga organe të ngarkuara me ligj për të dhënë drejtësi. Përveç këtij kushti, këto organe duhet të shqyrtojnë dhe të vendosin për çështje që janë në kompetencë të tyre gjatë një procesi të zhvilluar mbi një procedurë ligjërish të përcaktuar dhe në pajtim me rendin juridik. E

¹ Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo dhe Sonila Bejtja.

Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Elsa Toska dhe Fiona Papajorgji.

drejta e çdo pale për t'u dëgjuar në seancë përpara një gjykate kompetente dhe të caktuar me ligj nënkupton që gjykata të ketë juridiksion për të gjykuar çështjen dhe që kompetenca për të vendosur për të t'i jetë njohur nëpërmjet ligjit (*shih vendimin nr. 2, datë 29.1.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Këtë parim Gjykata e ka parë të lidhur ngushtë edhe me përbërjen e trupit gjykues të ngarkuar për shqyrtimin e çdo çështjeje konkrete (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

47. Sipas përmbajtjes së nenit 181 të KPC-së, në fuqi në kohën e shqyrtimit të kësaj çështjeje: *“Gjykata duhet të organizojë punën që gjykimi i çështjes të përfundojë nga i njëjti trup gjykues. Kur për shkaqe të parashikuara nga paragrafi i tretë i nenit 62 të këtij Kodi, ose për shkaqe të tjera të përligjura, ndryshon përbërja e trupit gjykues, anëtari i ri duhet të njihet me përmbajtjen e procesit gjyqësor, përveç kur kërkohet prej tij që çështja të shqyrtohet nga fillimi. Kur ndryshon më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues, çështja fillon nga fillimi.”*. Gjykata vëren se gjykimi i kësaj çështjeje në shkallë të parë ka filluar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarët A.M., G.H. dhe TH.N. Me shortin e datës 7.4.2009, trupi gjykues është plotësuar me gjyqtarin E.M., i cili ka zëvendësuar gjyqtarin G.H., që është emëruar në një gjykatë tjetër. Në seancën gjyqësore të datës 7.4.2009, ku ka qenë i pranishëm kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij, gjykata u ka bërë me dije palëve zëvendësimin e anëtarit të trupit gjykues, i cili është shprehur që *“gjykimi të vazhdojë aty ku ka mbetur”*. Kurse me shortin e datës 24.11.2009 trupi gjykues është plotësuar me gjyqtarin H.S., i cili ka zëvendësuar gjyqtarin TH.N. Në seancën gjyqësore të datës 25.11.2009, ku kërkuesi dhe përfaqësuesi i tij kanë qenë të pranishëm, palët janë njohur me përbërjen e re të trupit gjykues dhe gjyqtari H.S. ka kërkuar *“të procedohet në atë fazë në të cilin ka ngelur gjykimi pasi u njoh me materialet e dosjes.”*. Në të dyja këto seanca gjyqësore palët kanë qenë dakord me trupin gjykues dhe nuk kanë pasur kundërshtime ose vërejtje. Po ashtu, rezulton se zëvendësimi i anëtarëve të trupit gjykues, në të dyja këto raste, është bërë në bazë të shortit, duke u respektuar dispozitat përkatëse procedurale.

48. Rezulton, gjithashtu, se ky pretendim i kërkuesit është marrë në shqyrtim edhe nga Gjykata e Lartë, e cila, në zbatim të kompetencës së saj për interpretimin e ligjit dhe vlerësimin të zbatimit të tij nga gjykatat më të ulëta, ka vlerësuar, se: *“zëvendësimet e anëtarëve janë bërë në kohë të ndryshme dhe jo në të njëjtën seancë gjyqësore dhe nga ana e tyre është deklaruar se janë njohur me materialet e dosjes dhe janë dakord që të vazhdojë gjykimi aty ku ka ngelur. Në asnjë seancë nuk rezulton që të jenë ndryshuar më shumë se një nga anëtarët e trupit gjykues.”*.

49. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuesit është i papabazuar.

DH. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor

50. Sipas kërkuesit, gjykatat i kanë mbështetur konkluzionet e tyre vetëm në përfundimet e ekspertit, sipas të cilit është e vështirë të pasqyrohet vendndodhja e pasurisë së shtetasit Xhelal Meli, ndërkohë që ajo do të përcaktohej lehtësisht nëse do të thërrisnin ekspertë me njohuri të posaçme. Për më tepër, aty ka ekzistuar edhe shtëpia e banimit dhe prona ka qenë e regjistruar edhe në regjistrin hipotekor të vitit 1942. Gjykatat janë shprehur se paditësit i mungon legjitimitimi aktiv, me arsyetimin se dokumenti arkivor i paraqitur nuk përbën provë për legjitimitimin, ndërkohë që dokumentin arkivor për pasurinë e Meminajve e konsideron si provë për legjitimitimin e ndërhyrësit kryesor. Gjykatat duhej të arsyetonin nëse pasuria e ndërhyrësit kryesor është brenda pasurisë së trajtuar me vendimin e AKKKP-së Vlorë për të cilën është vendosur sekuestro preventive. Ato nuk i kanë dhënë përgjigje të arsyetuar as faktit se shtetasi Nikolin Kodhima është dënuar me vendim të formës së prerë për falsifikimin e vendimeve objekt i padisë që lidhen me kthimin e pronës. Pavarësisht shkeljeve të konstatuara në këtë proces gjyqësor, Gjykata e Lartë i legjitimoi ato duke lënë në fuqi vendimet e gjykatave të faktit.

51. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142, pika 1, të Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Domosdoshmëria e arsyetimit të vendimeve gjyqësore është

një garanci për procesin ligjor. Funkzioni i një vendimi të arsyetuar është t'u tregojë palëve se ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsyetuar, mund të realizohet edhe vëzhgimi publik i administrimit të drejtësisë (*shih vendimin nr. 18, datë 15.3.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata vëren se edhe në lidhje me pretendimin për mungesën e arsyetimit nga gjykatat e zakonshme, lidhur me pretendimet e parashtruara në gjykim nga kërkuesi për sa i takon vendndodhjes së pronës, nuk u arrit shumica e votave të gjyqtarëve², ndaj ai konsiderohet i rrëzuar në kuptim të nenit 73, pika 4, të ligjit nr. 8577/2000.

53. Në përfundim, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur nga kërkuesi Astrit Meli është e pabazuar, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72, 73, pika 4, e vijuese të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 9.3.2021.

Shpallur më 6.4.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Përparim Kalo, Fiona Papajorgji

² Votuan për pranimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji.

Votuan për rrëzimin e këtij pretendimi gjyqtarët: Vitore Tusha, Elsa Toska, Përparim Kalo dhe Sonila Bejtja.